

VENDIM
Nr.605, datë 20.10.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është hartimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë së pavarësisë dhe të mbrojtjes së tërësisë territoriale të vendit, si dhe rendit të tij kushtetues, në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Fusha e përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Ministria e Mbrojtjes planifikon e përballon emergjencat civile dhe vendos bazën juridike e administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes e kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.

5. Vendimi nr.501, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama